



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës  
trajtimet ose dënimit të egër, çnjerëzor poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300528/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** Rekomandim për inspektimin e kryer në ambientet e Komisarariatit të Policisë Mat.

**Drejtuar:** Drejtues i parë Dhimitraq ZIU  
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër

**PESHKOPI**

Z. Edmond HALA  
Shef i Komisarariatit të Policisë Mat

**BURREL**

**Për dijëni:** Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU  
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit

**TIRANË**

*Të nderuar zotërinj,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Komisariatin e Policisë Mat nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimet ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu inspektimin në Komisariatin e Policisë Mat në datën 01.06.2023 sipas një Plani Inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Hazbi Selita, znj. Nertila Qafzezi dhe z. Besnik Deda, me detyrë Nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimin dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, procedurën standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si

dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen dhe trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë Mat, z.Edmond Hala , i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Pasi u njoh me qëllimin e inspektimit, shefi i komisarariatit informoi grupin e inspektimit mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm; kushtet në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit; masat e marra për përmirësimin e kushteve në ambientin e shoqërimit, sipas kritereve të përcaktuara në procedurat standarde dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim, si dhe angazhimin e punonjësve të policisë së këtij komisarati për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente.

Grupi i punës inspektoi ambientet e shoqërimit, u njoh me regjistrat dhe dokumentacionin ku pasqyrohen të dhënat dhe veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar, si dhe vizitoi zyrat e punës të punonjësve të policisë të këtij komisarati.

Nga informacioni i drejtuesve të komisarariatit, si dhe nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm<sup>1</sup>, rezultoi se:

1. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për mbylljen e ambienteve ekzistuese të sigurisë në Komisariatin e Policisë Mat, si dhe për ndërtimin e ambienteve të reja të parashikuara në dokumentin e “Detyrë/Projektimit” sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde “*Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

2. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për ndërtimin e ambientit të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Mat, sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, të ndara më vete për personat e rritur, femrat dhe të miturit, duke krijuar mjedise të përshtatshme dhe dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera.
3. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për instalimin e sistemit të kamerave në këtë komisarati, për mbajtjen në vëzhgim të korridorit, ambientit të intervistimit dhe ambientit të shoqërimit.

---

<sup>1</sup> Rekomandimi i dërguar me shkresën nr. K4/I40-2 Prot., datë 15.11.2022.

4. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e dhomës (zyrës) së intervistimit/ marrjes në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar, të rritur dhe të mitur në këtë komisariat.
5. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për instalimin e sistemit të ngrohjes në ambientin e sigurisë dhe atë të shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
6. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare dhe të menjanimit të lagështirës në të gjitha ambientet e këtij komisariati.

Nga inspektimi dhe nga informacioni i drejtuesve të policisë Burrel, na infomoi se me përfundimin e ndërtimit të godinës së Drejtorisë/Komisariatit të Policisë Dibër, në vijim të këtij projekti është parashikuar edhe rikonstruksioni i Komisarariatit të Policisë Mat. Sipas tyre, janë në pritje të fillimit të procedurave për miratimin e fondeve për rikonstruksionin e këtij institucioni.

Avokati i Popullit vlerëson faktin se do të ketë investim në këtë institucion dhe nisur nga precedentet e mëparshëm kërkon të bëhet një punë e kujdeshme në fazën e projektimit dhe preventivit në mënyrë që godina e re të ndërtohet plotësisht në përputhje me standardet e përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, procedurën standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimin dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, procedurën standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e vizitës inspektuese, vijoi takimin me punonjësën e informacionit në Komisarariatit të Policisë Mat, inspektoi kushtet e mjedisit të shoqërimit, vizitoi zyrat e punës të punonjësve të policisë, të cilët kryenin veprime procedurale hetimore me personat e shoqëruar, si dhe u njoh dhe administroi dokumentacionin ku ishin evidentuar të dhënat dhe veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, gjatë kohës së qëndrimit në mjediset e këtij komisariati.

Qëllimi i kësaj procedure është përcaktimi i rregullave teknike dhe standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë dhe detyrimeve ligjore që kanë punonjësit e policisë për respektimin e garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë Mat me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë komunikimit dhe inspektimit që u zhvillua në ambientet e këtij institucioni.

Në përfundim të inspektimit, pavarësisht disa masave që ishin marrë për respektimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, në Komisarariatit të Policisë Mat vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika thelbësore si më poshtë:

#### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Ambienti i shoqërimit në Komisarariat e Policisë Mat, **nuk** ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit<sup>2</sup>.

Grupi i inspektimit konstatoi se ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës së komisarariatit dhe përbëhej nga 1 (një) dhomë për personat e rritur. Ndërsa personat e shoqëruar femra dhe të mitur në konflikt me ligjin, sipas informacionit, mbaheshin në zyrat e punonjësve të policisë, në prani të kujdestarit ligjor, avokatit mbrojtës dhe psikologut.

Dhoma e shoqërimit ishte me sipërfaqe 4x4m dhe me kapacitet deri 4 persona. Dritarja e dhomës ishte me përmasa të tilla që lejonte hyrjen e ajrit dhe dritës natyrale. Ajo ishte e lyer, por lagështira ishte e dukshme në këtë ambient. Dhoma e shoqërimit **nuk ishte e pajisur** me orenditë e nevojshme, si tavolina dhe karrige/stola për të mundësuar qëndrimin ulur të personave të shoqëruar<sup>3</sup>. Dera e dhomës së shoqërimit mbyllej me çelës dhe kishte bravë të rregullt.

Në këtë ambient, ngjitur me dhomën e shoqërimit ndodhej një tualet, i cili ishte i përbashkët dhe jo i ndarë më vete për meshkuj dhe femra<sup>4</sup>. Kushtet higjieno-sanitare të tij nuk ishin të mira. Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon marrjen e masave, të menjëhershme për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare në këtë ambient.

Në mjedisin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë.

Për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar të rritur, femra dhe të mitur, përdorshin zyrat e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të cilat ndodheshin në katin e dytë të godinës.

Në mjediset e komisarariatit nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Në dhomën e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohjeje apo pajisje të tjera elektrike, për sigurimin e ngrohjes së ambientit, kryesisht në periudhën e dimrit.

Në kohën e inspektimit, kishte 4 persona të shoqëruar në ambientet e këtij komisarariatit. Ndërsa për periudhën Janar – Qershor 2023 në regjistër ishin evidentuar të dhënat për 98 persona të shoqëruar, nga të cilët 82 persona të rritur dhe 16 persona të mitur në konflikt me ligjin.

Gjithashtu, nga intervistimi me personat e shoqëruar, na u bë me dije se ishin të informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke iu siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë.

---

<sup>2</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

<sup>3</sup> Kreu VI, pika 3/d e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

<sup>4</sup> Kreu VI, pika 3/e e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

## **Ambientet e sigurisë, kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve**

Grupi i inspektimit konstatoi, se ambientet e sigurisë nuk ishin funksionale në këtë komisariat. Sipas informacionit të drejtuesit të komisariatit, dhomat e sigurisë janë të mbyllura me çelës dhe nuk përdoren që nga data 01.05.2023, dhe sa i përket personave të arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, ata dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër.

Institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar ka ngritur shqetësimin e vazhdueshëm për mbylljen e dhomave të sigurisë në Komisaratin e Policisë Mat, sipas procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

## **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në Komisaratin e Policisë Mat, u konstatua se regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, ishte i tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, duhet regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e regjistrit për personat e shoqëruar rezultoi se nuk ishin të regjistruar të gjithë personat sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe sipas procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

Sipas verifikimit të këtij regjistri, rezultoi se në ambientin e shoqërimit ndodheshin 4 persona të shoqëruar që në orën 05:00 të datës 01.06.2023, dhe megjithëse kishin mbi 4 orë në këto ambiente, nga evidentimi i regjistrit të personave të shoqëruar rezultonte **se ata nuk ishin të regjistruar nga punonjësi i zyrës së informacionit**. Sipas punonjësit të zyrës së informacionit, këta persona janë pasqyruar në regjistrin e evidentimit të ngjarjeve dhe do të pasqyroheshin menjëherë edhe në regjistrin e personave të shoqëruar. Në pikën VIII të procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, thuhet se: “Akti/veprimi i shoqërimit, detyrimisht evidentohet dhe dokumentohet në sistemin elektronik, në regjistra, në formularë dhe proceverbale”. Procedurat e evidentimit të veprimeve që janë kryer me të shoqëruarin kryhen nga punonjësi i policisë që ka punuar dhe sqaruar çështjen, ndërsa hedhja e të dhënave në regjistër dhe në sistemin elektronik të të dhënave kryhet nga punonjësit i policisë të shërbimit të informacionit në njësinë policore. Moszbatimi i kësaj kërkesë nga personat përgjegjës për dokumentimin e aktit të shoqërimit, përbën **shkelje të rëndë disiplinore**.

Grupi i inspektimit, në intervistat me të shoqëruarit evidentoi si shqetësimin kryesor se ata ishin në pritje të marrjes në pyetje nga oficeri i policisë gjyqësore edhe pse kishin kaluar rreth 4 orë në ambientet e këtij komisariati.

Ne vlerësojmë se vonesa e marrjes në pyetje të shoqëruese në ambientet e komisariatit nga oficerët e policisë gjyqësore nuk është aspak korrekt dhe është qartas në kundërshtim me aktet normative në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e policisë gjyqësore, që parashikojnë atributet e saj dhe të organit të procedimit penal. Kjo sjellje nuk i shërben hetimit të veprave penale, zbulimit të autorëve dhe ndëshkimit të tyre nga organet e drejtësisë. Ndërkohë ajo sjell pasoja serioze në jetën e qytetarëve dhe cenimin e të drejtave të tyre kushtetuese e ligjore.

Gjithashtu nga evidentimi i këtij regjistri rezultoi se ai nuk është i plotësuar në mënyrë të rregullt për të gjitha rubrikat, sipas përcaktimeve në procedurën standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”<sup>5</sup>. Konkretisht, në rubrikën për njoftimin e familjes mungonte emri i personit të njoftuar, lidhja me të shoqëruarin, si dhe numri i telefonit të familjarëve. Në disa nga rastet e tjera të shoqërimit, në regjistër mungonte edhe përshkrimi i arsyes së shoqërimit, ora e shoqërimit të personave dhe ora e lënies së lirë. Kjo praktikë, përbën shkelje të standardeve dhe mos kryerje të detyrës nga punonjësit e policisë që kryejnë shërbim në zyrën e informacionit të këtij komisariati, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore. Njëkohësisht, këto shkelje çojnë në dyshime të arsyeshme se, një pjesë e shënimeve mund të jetë fiktive, përse nuk ka të dhëna në lidhje me identifikimin e familjarëve.

Në vijim, nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 10 orë në raste të veçanta.

Në këtë komisariat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar.

Nga inspektimi u konstatua se Komisarati i Policisë Mat, ishte pajisur me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë vitit 2023 kishte të shoqëruar 16 të mitur në konflikt me ligjin. Ky regjistër ishte hapur në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit, për marrjen e masave, për pajisjen e komisarateve të policisë me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin<sup>6</sup>.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën që u krye inspektimi, nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisaratin e Policisë Mat, nuk ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë, për të cilët ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj

<sup>5</sup>Kreu VII, e procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”.

<sup>6</sup>Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “*Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur*”.

se ka dyshime të arsyeshme që kanë kryer një veprë penale. Në mungesë të kësaj dhome, këta persona merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit ndaj tyre.

Mbikëqyrja me kamera e mjediseve të komisariateve, përveç mjediseve ku çenohet privatësia, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

**Së pari**, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen si nga ana e të shoqëruarve, të ndaluarve apo të arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

**Së dyti**, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisariatit, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

**Së treti**, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve, të ndaluarve apo të arrestuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet përkatëse që hartojnë institucionet monitoruese të pavarura. Vlen të theksohet se ata shërbejnë për garantuar besimin e qytetarëve të Policia e Shtetit.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparshme ka rekomanduar marrjen e masave për ndërtimin e zyrave të posaçme, për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse konstatohet nga vlerësimet periodike të zhvilluara nga KKPT ky rekomandim ende nuk është plotësuar<sup>7</sup>.

Ndërkohë në këtë komisariat ishte krijuar një dhomë më vete për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale.

Gjithashtu, edhe intervistimi apo marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin që shoqërohen në mjediset e këtij komisariati, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në ambiente të veçanta, sikurse është e parashikuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe procedurën standarde<sup>8</sup>. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, intervistat me të miturit duhet të realizohen

---

<sup>7</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].

<sup>8</sup> Kreu VII, Pika 2.1/k e procedurës standarde thuhet se: “I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”. I mituri duhet të mbahet në dhoma/ambiente të ndarë nga personat madhorë dhe të ndarë nga të miturit e tjerë sipas gjinisë”.

në një ambient të përshtatshëm dhe të pajisur me orëditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, në një mjedis sa më të qetë, pa shtrëngime fizike dhe presione psikologjike. Në kushtet aktuale që ndodhen zyrat e punës të punonjësve të policisë, intervistimi i tyre mund të shkaktojë traumatizim plotësues tek të miturit.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre ju sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, por dhe në bashkëpunim me Shkollën e Mesme të qytetit të Burrelit. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Mat ishte zhvilluar konform ligjit.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë në Qendrën Shëndetësore Burrel, për të marrë ndihmën mjekësore.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit, ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454, date 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

### **REKOMANDOJMË:**

1. Drejtori i Drejtorisë Vendore Dibër të marrë masat për drejtuesit e komisarariatit për nxjerrjen e përgjegjësive lidhur me mosregjistrimin e personave të shoqëruar në regjistrin e shoqërimit dhe mungesa e formularit të shoqërimit në këtë institucion, referuar ditës së inspektimit të dates 01.06.2023.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Mat, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orëditë e nevojshme për qëndrimin në dhomat e shoqërimit të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur në konflikt me ligjin dhe ndërtimin e godinës së re të Komisarariatit të Policisë Mat në përputhje me procedurën standard *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*.



3. Marrjen e masave të menjëhershme, për organizimin e trajnimeve me stafin e punonjësve të policisë që kryejnë shërbim në zyrën e informacionit, për plotësimin e regjistrit të të shoqëruarve që në momentin e hyrjes në komisariat dhe sipas të gjitha rubrikave, evidentimin e të dhënave të sakta të tyre mbi arsyen e shoqërimit, orën e shoqërimit të personave në mjediset e policisë së shtetit, orën e lënies të lirë të tyre, si dhe të rubrikës për njoftimin e familjarëve me emrat, lidhjen familjare me të shoqëruarin dhe numrin e telefonave të tyre, sipas përcaktimeve në procedurën standarde dhe rekomandimeve CPT-së për këtë qëllim.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në ambientin e dhomës së shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Mat.
5. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm, ku intervistohen/merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës<sup>9</sup>.
6. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për mbylljen dhe dyllosjen e dhomave të sigurisë në këtë komisariat, sipas procedurës standarde "*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*", miratuar me urdhrin nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe nxjerrjen e akteve ligjore nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për ndryshimin e këtyre ambienteve për hapësira të tjera të ndryshme në funksion të institucionit.
8. Marrjen e masave të nevojshme, për pajisjen e dhomës së shoqërimit, me orenditë e nevojshme si tavolinat dhe karrige, të cilat shërbejnë për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat duhet jenë të fiksuara në dysheme dhe të pa lëvizshme, sikurse përcaktohet në procedurat standarde.
9. Marrjen e masave të nevojshme, për instalimin e sistemit të ngrohjes në ambientin e sigurisë dhe atë të shoqërimit, për shkak të kushteve të rënduara atmosferike të kësaj zone.
10. Marrjen e masave të menjëhershme, për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare dhe eliminimit të lagështirës në të gjitha ambientet e këtij komisariati.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**AHMET PRENÇI**

<sup>9</sup> Kreu VII, pika 4/d e Procedurës standarde "*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*".

